

Njoftim

Sot, më datë **15.06.2023**, ora **16:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Edlira Petri (Relatore);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 5. Emona Muçi (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.29 Regj.Themeltar, Datë 09.06.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Av. Franci Nuri.

I paditur: Komisionit Qendror i Zgjedhjeve – KQZ, përfaqësuar nga Ina Osmanaj dhe Blendi Kodra.

Persona të interesuar: - Subjekti Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Maringlen Legisi dhe Andi Skënderi.
- Subjekti Zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”.

Objekti: Ndryshimin e Vendimit nr.176, datë 07.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:
Prishjen e Vendimit të KSHZ nr.536, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”, duke vendosur:
(i) Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonen zgjedhore Bashkia Kamëz; dhe
(ii) Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Kamëz me anë të votimit tradicional me fletë votimi fizike.

Baza ligjore: Neni 3/1, Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ; Nenet 4, pika 1, Nenet 9, Neni 45, Neni 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë, Nenet 63, 64, 65, 98, Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit, si dhe nenet 136, 139, 145 e vijues i Kodit Zgjedhor.

vendosi shtyrjen e seancës gjyqësore me kërkesë të të paditurit, për shkak të angazhimeve të paracaktuara të tij në raport me datën e seancës gjyqësore.

Për një proces të rregullt ligjor seanca gjyqësore u shty dhe u riplanifikua më datë **19.06.2023, ora 09:00**, në: **ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë.**

Tiranë, më 15.06.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë